




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.09.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-1776/14, për znj. Jelena Milenkovic – Drejtoreshë e Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë, Inspeksion dhe Shërbime Emergjente në Zyren Administrative të Veriut të Mitrovicës, për shkak se zyrtarja e lartë publike ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-1776/14, për znj. Jelena Milenkovic – Drejtoreshë e Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë, Inspeksion dhe Shërbime Emergjente në Zyren Administrative të Veriut të Mitrovicës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtarja e lartë znj. Milenkovic, është hetuar për situatë të konfliktit të mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik si zyrtare e lartë në Zyrën Administrative të Veriut të Mitrovicës dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, S.T.R. BUTIK “LALA”.

Ajo fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit. Më pas, është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t'i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet t'i bëjë në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

znj. Milenkovic, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të emëroj një person të besueshëm për të menaxhuar biznesin e saj privat, dhe ka deklaruar se këtë do ta bëj në afatin e caktuar nga Agjencia.

Mirëpo ajo nuk e ka respektuar këtë afat, prandaj AKK i ka dërguar shkresën e dytë me të cilën i ka caktuar një afat të dytë me ç' rast i ka tërhequr vërejtjen se nëse nuk respektohet do të kërkohet shkarkimi i saj nga funksioni publik. Ndërkohë, znj. Milenkovic ka respektuar afatin e dhënë nga kjo shkresë dhe ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 3203/14) me të cilën vërtetohet se ajo ka emëruar një person të besueshëm si person të autorizuar në biznesin privat. Me këtë ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

U skladu sa članom 11(stav1.1), člana 5 (stav 1 tačka 1.5), člana 18(stav10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije kao i člana 19 (stav 11) Pravilnika br. 01/2014 o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije protiv Korupcije je dana 22.09.2014 doneo

R E Š E N J E

I. Zatvara se slučaj br. AKK – 03-1776/14 za g-đu Jelena Milenković- Direktor Uprave za JavneUsluge, Infrastrukture,Inspekcije i Hitne Službe u Administrativnoj kancelariji Severne Mitrovice, zato što je visoki javni zvaničnik, gđa Milenković izbegla sukob interesa u kojem se nalazila.

II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se jave nove okolnosti.

O b r a z l o ž e n j e

I. Slučaj otvoren pod osnovanom sumnjom za Sukob Interesa u vršenju javne funkcije, pod br. AKK – 03-1776/14, za g-đu Jelena Milenković – Direktor Uprave za Javne Usluge, Infrastrukture,Inspekcije i Hitne Službe u Administrativnoj kancelariji Severne Mitrovice tertian je u zakonom predviđenoj proceduri, za sprečavanje sukoba interesa u vršenju javne funkcije (Zakon br. 04/L-051).

U ovom slučaju je visoki zvaničnik g.đa Milenković je istraživana za moguću situaciju sukoba interesa u toku vršenja javne funkcije kao visoki zvaničnik u Administrativnoj Kancelariji Severne Mitrovice i istovremeno ovlašćeno lice u privatnom biznisu, S.T.R. BUTIK "LALA".

Ona je prvo obavestena službenim pismom od strane Agencije protiv Korupcije, za početak procedure razmatranja stanja mogućeg sukoba interesa. Nakon toga, ona je kontaktirana od strane službenika Agencije da bi joj se objasnilo stanje u kojem se nalazila i date su preporuke za izmene koje treba vršiti , kako bi izbegla situaciju sukoba interesa.

g-đa Milenković je prihvatila preporuke Agencije da imenuje jedno poverljivo lice da bi upravljao sa privatnim biznesom, i izjavila da će to izvršiti u roku određenog od strane Agencije.

Ali, g-đa Milenković ovaj rok nije ispoštovala, te je APK poslao drugo pismo u kojem je određen drugi vremenski rok i tom prilikom mu skrenuta joj je pažnja da ukoliko ne poštuje i ovaj rok, da će se zatražiti njeno smenjivanje sa funkcije. U međuvremenu, g-đa Milenković je poštovalla određeni rok, te je poslala u Agenciju službeni dopis Agencije za Registraciju Biznesa na Kosovu (DPKI 03 - 3203/14) kojom se potvrđuje da je ona imenovala kredibilno lice kao ovlašćeno lice u privatnom biiznisu. Ovim je ona izbegla moguću situaciju sukoba interesa u kome je bila.

II. Uskladu sa članom 18 (stav 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može obnoviti slučaj u svako doba ukoliko se pojave nove okolnosti. Stoga je odlučeno kao u dispozitivu ove odluke .

Rešenje se dostavlja :

- Visokom javnom zvaničniku
- Direktor DSK
- G./G-đi (odgovornom službeniku)
- G./G-đi. (pomoćnom službeniku)

Direktor Agencije protiv Korupcije

Hasan Preteni

